



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel+ 383 38 212 309 e-mail [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSh. Nr. 1131/22**

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në bazë të nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje nga Vedat Poterqoi kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani- Anëtar dhe Isa Hasani- anëtar, pas shqyrtimit të kërkesës për diskualifikim të ushtruar nga Komuna e Prizrenit në cilënë e Autoritetit Kontraktues (AK), (Nr.Protokolli 1131/22), ushtruar ndaj Operatorit Ekonomik Asphalt Group Sh.p.k - Klinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Rregullimi i infrastrukturës ne lagjen Dardania 2 – Projekt dy vjeçar, me nr: te prokurimit: 622-22-7588-5-1-1, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës dhe nenit 32 të Rregullores së Punës së OSHP, me 28.02.2024, mori:

## V E N D I M

1. Aprovohet, si e bazuar kërkesa e Komuna e Prizrenit në cilësin e Autoritetit Kontraktues, e datës 23.11.2022, kurse OE Asphalt Group Sh.p.k - Klinë, diskualifikohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për periudhën kohore në kohëzgjatje 3/tre muaj, duke filluar nga data 28.02.2024 deri me datën 27.05.2024, për shkak se i njëjti ka dështuar ne dorëzimin e dëshmimeve te përshtatshmërisë sipas nenit 25.9 te Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022.
2. Urdhërohet AK (me shënime si më sipër) që ta konfiskoj shumën e mjeteve të deponuara nga OE Shpat Turs Sh.p.k - Gjakovë në emër të sigurimit të ofertës, siç parashihet me nenin 57, paragrafi 1.1, të LPP.

## A r s y e t i m

### Kërkesa e AK - Komuna Prizrenit:

Autoriteti kontraktues përmes kërkesës së datës: 23.11.2022, pretendon se OE Asphalt Group Sh.p.k - Klinë, si pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me titull: Rregullimi i infrastrukturës në lagjen Dardania 2 – Projekt dy vjeçar, me nr: të prokurimit: 622-22-7588-5-1-1, pas përfundimit të vlerësimit të ofertave dhe rekomandimit për kontratë nga ana e komisionit vlerësues, AK-ja konform dispozitave të LPP-se deklaroi se i kemi kërkuar dëshmitë - vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë, vërtetimin e ATK-se, vërtetimin e Gjykatës Themelore dhe vërtetimin e tatimit në pronë.

Sipas autoritetit kontraktues, OE Asphalt Group Sh.p.k - Klinë, në përgjigje të kërkesës, ka deklaruar:

From: asphaltgroup4v [mailto:asphaltgroup4v@gmail.com]  
Sent: Thursday, October 27, 2022 12:37 PM  
To: Isa Osmankaj <Isa.Osmankaj@rks.gov.net>  
Subject: RE: Kërkesë për dëshmitë administrative

Përsëritje!

Me këqardhje ju konfirmojë se në si kompani nuk jemi të gatshëm që të dorëzojmë dokumentacionin e kërkuar për shkak se kemi obligim ndaj ATK dhe nuk mund të të nxjerrim, Vërtetim nga Administrata Tatimore. Andaj kërkojmë falje për vonesë në përgjigjen tonë por kjo ka ndodhur si shkak i angazhimit tonë për kompletim të dokumentacionit.  
Çdo të mirë!

Andaj, AK-ja, kërkesën e saj e bazon në deklaratën e OE Asphalt Group Sh.p.k - Klinë që nuk i ka dorëzuar vërtetimet e përshtatshmërisë dhe rrjedhimisht pretendon se operatori ekonomik ka vepruar në kundërshtim me nenin 25.9 të Rregullores për Prokurim Publik nr: 001/2022 dhe njëherit autoriteti kontraktues kërkon marrjen e masave eventuale sipas nenit 99.2 të LPP-se.

### Kërkesa e OSHP-së drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me të pranuar kërkesën e datës: 23.11.2022 të AK- Komuna e Prizrenit, e ka njoftuar OE Asphalt Group Sh.p.k, me qëllim që operatori ekonomik në fjale të jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

OE Asphalt Group Sh.p.k, deri me sot nuk ka kthyer përgjigje në kërkesën e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Paneli shqyrtues, bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe provat e administruara, ka konstatuar se qëndrojnë pohimet e AK-se, sikurse janë përshkruar ato ne kërkesën e datës: 23.11.2022, sepse OE Asfalt Group Sh.p.k - Klinë, në përgjigje te kërkesës se autoritetit kontraktues lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë, ka deklaruar se nuk janë te gatshëm ti dorëzojnë vërtetimet për shkak te obligimeve ne Administratën tatimore te Kosovës. Pra, OE Asfalt Group Sh.p.k – Klinë, ka vepruar ne kundërshtim me nenin 25.9 te Rregullores për Prokurim Publik, ne te cilin thuhet:

25.9 Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më shumë se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se.

Paneli shqyrtues, vlerëson se janë plotësuar kushtet për zbatim te nenit 99 paragrafit 2 te LPP-se, për marrjen e masave eventuale sipas nenit te cituar me lart, sepse veprimet e operatorit ekonomik pas dorëzimit te ofertave sanksionohen me dispozitat e neneve te përmendura me lart.

Andaj, paneli shqyrtues vendos qe OE Asfalt Group Sh.p.k – Klinë, te vendoset ne listën e zezë ne kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.

Duke ju referuar të lartëcekurave si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 99.2 te LPP, Paneli shqyrtues, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit  
Vedat Poterqoi

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, kurse pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet me kërkesëpadi Gjykatës Kompetente për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Prizren

1x1 OE Asfalt Group Sh.p.k

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së